



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 04-610/01-11559/26
Kaçanik, 29.05.2026

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunat Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, të nenit 6 pika 3 paragrafi 1, Neni 14 Përbërja e komisionit përzgjedhës me paragrafi 8.1 dhe 8.2 të Rregullores (QRK) - Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mesimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe pas shtufizimit të nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 me Aktgjykim P.A.nr.5/2025 të datës 23prill 2026 nga Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Drejtorisë së Arsimit, 01Nr. 04-610/01-11559/26 të datës 18.05.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 maj 2026, mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor dhe zëvendës drejtor të institucioneve arsimore

1. Me këtë Vendim, emërohet Komisioni përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për pozitën Drejtor dhe Zëvendës drejtor të institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në IAAP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik, SHF MU "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër, SHF MU "Jusuf Gërvalla" në Biçec, SHF MU "Katër Dëshmorët" në Kovacec, SHF MU "Nazmi Osmani" në Elezaj, dhe SHF MU "7 Shtatori" në Begracë, në këtë përbërje:

- 1.1 Gafurr Guri, drejtues i ulët në DKA, kryetar i komisionit;
- 1.2 Rrenzije Dardhishta, profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë shqipe, anëtare; dhe
- 1.3 Një(i) përfaqësues i MASHIT-it, anëtar; dhe
- 1.4 Dy përfaqësues të kështillit drejtues në cilësinë e vëzhguesve në komisionin e përbashkët të emërimit.

2. Komisioni ka për detyrë:

- të shqyrtojë aplikacionet e kandidatëve;
- të verifikojë përmbushjen e kriterëve ligjore dhe profesionale;
- të zhvillojë procedurat e vlerësimit dhe intervistimit;
- të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve të rekomanduar;
- të sigurojë zbatim të drejtë, transparent dhe të paanshëm të procedurës së përzgjedhjes, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyriën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria dhe Arsimit.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit (përmes kësaj drejtorie njoftohen anëtarët e komisionit); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni